

Në bazë të nenit 28, paragrafit 1, të Ligjit për mjedisin jetësor ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 53/05, 81/05, 79/06, 101/06, 109/06, 24/07, 159/08, 83/09, 161/09, 1/10, 48/10, 124/10, 51/11, 123/12, 93/13, 187/13, 42/14, 44/15, 129/15, 192/15, 39/16, 28/18, 65/18 dhe 99/18) dhe nenit 27, paragrafit 1, pikës 6, të Statutit të Universitetit të Evropës Juglindore, Bordi i Universitetit, në mbledhjen e mbajtur më 9.09.2019, e miratoi këtë:

## **RREGULLORE PËR RUAJTJEN E AMBIENTIT NË UNIVERSITET**

### **Objekti i rregullimit**

#### **Neni 1**

Me këtë rregullore përcaktohet ruajtja e ambientit jetësor, me qëllim të zhvillimit dhe përdorimit të qëndrueshëm të energjisë dhe për promovimin e vetëdijes në lidhje me çështjet e ruajtjes së ambientit.

### **Ruajtja e ambientit në Universitet**

#### **Neni 2**

- (1) Rreptësisht ndalohet hedhja e mbeturinave në sipërfaqet e kampusit, ose hapësirave të Universitetit. I gjithë stafi, studentët dhe vizitorët, duhet t'i përdorin kapacitetet e instaluar (shportat dhe kontejnerët), për këtë qëllim.
- (2) Letra, plastika dhe kanoçet hidhen vetëm në kontejnerë të posaçëm për riciklim.

#### **Neni 3**

Ndalohet shkelja e barit dhe dëmtimi i drurëve, ose bimëve.

#### **Neni 4**

Rreptësisht ndalohet pështymja kudo në hapësirat e Universitetit.

#### **Neni 5**

Ndalohet dëmtimi i ndërtesave (brenda dhe jashtë), ose cilësdo pronë të Universitetit.

#### **Neni 6**

Shërbimi i sigurimit dhe mirëmbajtjes së UEJL-së, do ta monitorojë zbatimin e kësaj rregulloreje.

### **Sanksionet**

#### **Neni 7**

Çdo shkelje e kësaj rregulloreje, do të regjistrohet nga Shërbimi i sigurimit, i cili mund të japë vërejtje. Shkeljet e përsëritura, do të raportohen në Zyrën e burimeve njerëzore, të cilët realizojnë gjorbë varësisht me dëmin dhe/ose do të marrin masa disiplinore.

### **Dispozitat përfundimtare**

#### **Neni 8**

Kjo rregullore hyn në fuqi më 01.10.2019.